

**RAPORT I AUDITUSIT TE PAVARUR**  
**Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara**  
**nga Partia Demokratike për Integrim dhe Prosperitet**

**Fushata zgjedhore 2011**  
**Periudha 7/04/2011 - 7/05/2011**

**PËR: KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Bulevardi: "Dëshmoret e Kombit"**

**Pallati i Kongreseve, Tirane**

Të nderuar zotërinj,

Unë, Hidajete Kraja (Muçaj), në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.1232, dt.07.11.2011, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.6440/1, dt.17.11.2011, kam audituar pasqyrat bashkëlidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, që fillon me datë 07.04.2011 me regjistrimin e Partisë Demokratike për Integrim dhe Prosperitet, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 07.05.2011 me përfundimin e fushatës zgjedhore të 08 Majit të vitit 2011.


Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë Demokratike për Integrim dhe Prosperitet. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazën e arketimeve dhe pagesave. Subjekti deklaron se nuk ka përfituar asnjë fond dhe nuk ka bërë shpenzime. Subjekti zgjedhor Partia Demokratike për Integrim dhe Prosperitet nuk kishte hapur ndonjë llogari të posaçme në ndonjë bankë për dhurimin e fondeve jopublike dhe nuk na u deklarua ndonjë numer llogarie si dhe asnjë dhurim për subjektin.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsishme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posaçëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë cmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.

Adresa e Audituesit: Rr. "Çajupi", Pallati Fishta 2, kati 2, Shkodër.  
Tel: 02249719, Cel: +355 69 40 69 929, e-mail: [hydi\\_eka@yahoo.com](mailto:hydi_eka@yahoo.com)

  
EKSPERTE  
\*  
HIDAJETE KRAJA  
REGJISTRUAR  
\*  
NR. LIC. 107 DT. 21.12

